


GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Biljana Rexhiq, kryetare e kolegji, Dalip Bega dhe Ragip Namani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Sebahate Hoti, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, Rregj.nr.62581/2012, të datës 30.08.2013, në bazë të nenit 31 al.3, 39, dhe nenit 221 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më dt. 25.09.2013, murr:

AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

ABROGOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore -Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, Rregj.nr.62581/2012, të datës 30.08.2013, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës.
Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.



A r s y e t i m

Gjykata Themelore-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Rregj.nr.62581/2012, të datës 30.08.2013, e ka HUDHË kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje të iniciuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit, nr.01-4249-12, të dt. 23.11.2012, ndaj të pandehurës Ajmane Veseli, nga Prishtina, konform nenit 137 al. 1 pika 4 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me arsyetim se parashtruesi i kërkesës nuk i ka evitua të metat brenda afatit të caktuar.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur Agjencia Kundër Korrupsionit, për shkak të: Vendimit lidhur me rastin, në arsyetimin e ankesës shtojnë: Gjykata Themelore-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin nr. regj. 62581/2013, të dt. 30.08.2013, e ka Hudh kërkesën për iniciimin e procedurës për kundërvajtje të iniciuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit, kundër të pandehurës Ajmane Veseli, me arsyetim se Agjencia nuk i ka evitua të metat në afatin e kërkuar nga gjykata. Agjencia Kundër Korrupsion pas pranimi të shkresës së gjykatës me dt. 27.05.2013, në afatin e kërkuar nga gjykata, me dt.29.05.2013, me shkresën numër protokolli 01-1593, gjykatës ja ka dërguar informatat e kërkuara, si dëshmi për këtë ankesë ja bashkëngjisim flet kthesën e Postës së Kosovës, mirëpo edhe për kundër të gjitha informatave të ofruara, gjykata të pandehurës nuk e ka shpall fajtor, por e ka hudhë Kërkesën për iniciimin e procedurës .

Kolegji i Gjykatës së Apelit-Divizioni për Kundërvajtje, pas vlerësimit të thënieve në ankesën e paraqitura, aktvendimin e goditur, si dhe shkresat tjera të lëndës konstatoi se ankesa është e bazuar, ndërsa aktvendimi i goditur abrogohet dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Kolegji konstatoi se gjykata e shkallës së parë me rastin e hedhje së kërkesës për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurës Ajmane Veseli, nuk ka vepruar në mënyrë drejtë, sepse siç shihet nga shkresat e lëndës Gjykata Themelore-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, me datën 07.03.2013, komform nenit 136 ka marr konkluzion për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurës, ndërsa më dt. 24.05.2013, i drejtohet parashtruesit të kërkesës-Agjencisë Kundër Korrupsionit, dhe nga ta kërkon që në afatin prej 15 ditësh, të bëjnë plotësimin e kërkesës, për iniciimin e procedurës kundërvajtëse, ndaj të pandehurës Ajmane Veseli, me konstatim, në rast se nuk e bëjnë plotësimin, kërkesa do të hedhet poshtë, me supozim se të njëjtit kanë hekur dorë nga kërkesa, edhe për kundër faktit se në Kërkesë ka të dhëna se e pandehura ushtron funksionin në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Këtë veprim Gjykata e shkallës së parë ka mundë ta ndërmarrë vetëm në rastin kur ende nuk ka filluar procedura për kundërvajtje, gjeqësish nuk është marr konkluzion për fillimin e procedurës

Siç shihet nga shënimi zyrtar i cili gjendet në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës-Agjencisë Kundër Korrupsionit, si pas dëshmisë të cilën ja ka bashkëngjitur ankesës, ka bërë plotësimin e kërkesës dhe në afatin e paraparë ligjor të njëjtën ja ka dorëzuar gjykatës, andaj për këto shkaqe aktvendimi mbi hedhjen e kërkesës për iniciimin e procedurës kundërvajtëse si i tillë nuk mund të qëndroi

Në plotësim të procedurës Gjykata e shkallës së parë duhet të veproji sipas vërejtjeve të cekura më lartë, ta zhvilloi procedurën, të merre në pyetje të pandehurën lidhur me kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në bar, në rast nevojë të administroj edhe provat tjera, dhe pas nxirjes së provave dhe vlerësimit të tyre një nga një, dhe në tersi, të vendos lidhur me këtë çështje kundërvajtëse, duke nxirë aktvendim të ri dhe të bazuar në ligje .

Më sa u tha më lart konform nenit 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa
GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
KA. nr.1022/2013, të dt. 25.09.2013.

Procesmbajtësja
Sebahate Hoti

